



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 99/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër komisionarëve të PDK-së, për shkak të ndërrimit të Qendrës së Votimit (QV) disa votuesve, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat Anr. 99/2012 Anr.100/2012 dhe Anr. 102/2012 të datës 30.04.2012 të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

#### A r s y e t i m

PZAP, më datë 30.04.2010, ka pranuar ankesën Anr. 99/2012, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se familja e cila ka qenë dashur të votoj në fshatin Mirash (apo me siguri ka votuar) ka ardhur në vendvotimin nr 9 ka tentuar të votoj edhe një herë me përkrahjen e Azem Çerkinit anëtarë i KVV-së nga PDK-ja, mirëpo me intervenimin e Aferdita Zejnës anëtare e KVV-së edhe pse është fyer nga Azem Çerkini familja nuk është lejuar që të votoj.

PZAP, më datë 30.04.2010, ka pranuar ankesën Anr. 100/2012, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se një familje e cila ka qenë dashur të votoj në fshatin Mirash (apo me siguri ka votuar) ka ardhur në shkollën fillore “Tefik Çanga” dhe në vendvotimin nr 9 ka tentuar të votoj edhe një herë me përkrahjen e menaxheres së shkollës fillore “Tefik Çanga” në Ferizaj e cila ka dashur ta lejoj këtë familje të votoj por me reagimin e Aferdita Zejnës nuk është lejuar të votoj kjo familje.

PZAP, më datë 30.04.2010, ka pranuar ankesën Anr. 102/2012, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se në vendvotimin nr 1 në Nerodime, Hatixhe Aliaj ka tentuar që të votoj për së dyti. Sipas parashtruesit të ankesës kryesuesi i vendvotimit nr 1 pasi që e shikon librin e verifikon që e lartë përmendura kishte votuar më parë dhe nuk e lejon që të votoj, e ku ajo fillon të bërtas dhe të bëjë panik.

**Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:**

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6 paragrafi 3 parasheh:

- 6.3 *“Me qellim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, kryesuesi i panelit mund të vendose ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato si kur të ishin një ankese”.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**Ankesat janë të pabazuara.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesave, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkak se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për tu vërtetuar se kanë ndodhur shkeljet e pretenduar në ankese, pasi që nga ankesat e parashtruara nuk ka prova të mjaftueshme që do ta argumentonin se personave të caktuar ju është mohuar e drejta për të votuar ashtu siç e parasheh neni 5 i LZP-së, prandaj në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 99/2012 më datën 30.04.2012.

**Kryesuesi i Panelit  
Ymer Hoxha**

